



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:023288
Datë: 10.09.2024
Numri i dokumentit: 06141784

C-IV-13-0341

Ankuesi:

N B nga fshati L, Prizren.

Kundër:

E paditura:

NSH. NIN Ramiz Sadiku-Prizren ”,(në Likuidim)

Përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, lagja Lakrishtë rruga “Dritan Hoxha” nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtaren Ganimete Puka, me 10.shtator.2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr. PRZ017-0171 i datës 05.mars. 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. **Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 26.mars.2013, ankuesi parashtroj ankesë , për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) nr. PRZ017-0171 i datës 05.mars. 2013, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerjet të marrëdhënies së punë, në shumë prej 856.00 € nga N.Sh. „**NIN Ramiz Sadiku** ” (në likuidim). Ankuesi pohoi se, AKP ka refuzuar kërkesën e lartcekur duke pohuar se, kërkesat është e parashtruar pas afat të parashtrimit të kërkesave dhe siç theksohet në vendimin e AL kërkuessit nuk kanë prezantuar prova se ju kanë drejtuar ndonjë gjykate apo organi tjetër në lidhje me kërkesën e ankuesve. Ankuesi i propozon Gjykatës, që ankesën e tij ta aprovoj si të bazuar. Ankuesi ka bashkangjitur kopjen e vendimit të kundërshtuar të AL.

Me 13.mars.2013, gjykata lëshoj një vërejtje për ankuesin mbi pagesën e taksës gjyqësore. Me të njëjtën vërejtje ankuesi u informua se nëse taksa nuk paguhet brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr. I njëjti nuk ka paguar taksë gjyqësorë për ankesë.

Gjykata nuk e ka trajtuar të tërhequr ankesën e ankuesit për mos pagës të taksë gjyqësorë, duke ju referuar nenit 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, që përcakton që ku vlera e kërkesës është nën 1000€, palët lirohen nga taksa gjyqësorë dhe ka hyrë në shqyrtimin e çështjes në merito.

Me 12.prill.2018, ankuesi parashtror serisht një ankesë, duke mbetur në tersi pranë pretendimeve të theksuar në ankesën iniciale , më propozim që gjykata ta aprovoj ankesën në tersi si të bazuar.

Me 01.mars.2024, ankuesi ka pranua urdhrin e gjykatës, me të cilin ju është kërkuar që të sjell prova relevante në mbështetje të ankesë së tij. I njëjti nuk ka vepruar sipas urdhrin të gjykatës.

Me 04.shtator. 2023, e paditura AKP-ja parashtror mbrojtje, në të cilën pohoi se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashtruar në kundërshtim me nenin 74.2 të Ligjit 06/L-086 të DHPGJS. Më tej e paditura pohoi se ankesa e ankuesit është e pa bazuar , me arsyetim se ankuesi nuk është i përfshirë në listën e pagave për 12 muajt e fundit dhe nuk ka qenë punëtor aktiv i NSH. Si dhe ankuesi nuk është pushur nga puna si pasoj e veprimin të ndërmarr nga agjencia dhe ankuesit nuk i takon e drejta në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, sipas nenin 40.1.61.2 të Ligjit të AKP. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së.

Me 23.gusht.2024, ankuesi ka dhënë përgjigje ndaj mbrojtjes së AKP. Ankuesi i ka propozuar gjykatës që ankesën ta aprovon në tersi si të bazuar, me pretendimin se kërkesa/ankesa ka mbështetje ligjor në kuptim të dispozitave ligjor nga nenit 40 të shtojcës së LAKP, paragrafi 1.6.1 dhe 1.6.2. Më tej ankuesi ka pohuar se sipas urdhrin të gjykatës të gjitha provat i janë dorëzuar gjykatës . Ankuesi ka pohuar se më 11.korrik.2007, e ka pranuar njoftimin nga AKP, me të cilin është njoftuar se si rezultat i privatizimit të ndërmarrjes i ndërpritet marrëdhënia e punës, si dhe i njëjtit është udhëzuar për realizimin e pagave të pa paguara. Pastaj ankuesi ka shtuar se të gjitha pretendimet e të paditurës të cekur në mbrojtjen e saj nuk qëndrojnë , si dhe nuk qëndron pretendimi i të paditurës së kërkesa është e parashtruar . Nenit 366 par.1, i LMD/, parasheh se njohja me shkrim e detyrimit të parashtruar konsiderohet heqje dorë nga parashkrimi. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj në tersi ankesën e tij si të bazuar dhe të anuloh vendimin e kundërshtuar të AL .

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe parashtrësive të palëve.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)”*, ndërsa pika 3 parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”*.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Gjykata ka shqyrtuar të gjitha shkresat që gjenden në dosje të lëndës dhe pretendimet e palëve dhe ka konstatuar se kërkesa e ankuesit ka të bëjë me dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, në shumë prej 856.00 €, të cilat pretendohet të mos jenë paguar nga ana e NSH. Neni 40 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP parasheh prioritetin e kërkesave dhe interesave që duhet të përmbushen në procedurë të likuidimit, ndërsa pika 1.6.2 e po të njëjtit nen, parasheh kërkesa për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nga punonjësit të cilët janë pushur nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrjes nga Agjensioni sipas nenin 6.1 apo.6.2 të Ligjit të AKP/së.

E paditura në vendimin e saj PRZ017-0171, i datës 03.mars. 2013, ka refuzuar kërkesën e ankuesit si të pa bazuar, me arsyetim se ankuesi nuk është i përfshirë në listën e pagave për 12 muajt e fundit dhe nuk ka qenë punëtor aktiv në NSH. Si dhe ankuesi nuk është pushur nga puna si pasojë e veprimit të ndërmarr nga agjencia, dhe parashtruesit të kërkesës nuk i takon drejta në dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, sipas nenin 40.1.61.2 të Ligjit të AKP.

Gjykata vëren se ankuesi kërkesën për kompensimi për ndërprerje të parakohshmes të kontratës së punës, në shumë prej 856.00 €, nuk e ka mbështetur me prova para AL prandaj vendimi i AL konsiderohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Ankuesi edhe me ankesë para gjykatës nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se N.SH, ka detyrimi për dëmshpërblimi për ndërprerje të parakohshëm të kontratë së punës, dhe vetëm kopja e vendimit të atakuar e Autoritetit të Likuidimit nuk është dëshmi me të cilat dëshmohet se NSH , ka detyrimin për një kërkesë të tillë , prandaj edhe ankesa e tij është e pa mbështetur në prova dhe u refuzuar si e pa bazuar.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet të tjera të ankuesit, mirëpo ka ardhur në përfundim se pretendimet e tija janë të pa mbështetur në prova në shkresat të lëndës dhe nuk ka vend për një vendim me ndryshe, dhe u vendos që ankesa e ankuesi të refuzohet .

Në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Ganimete Puka

G j y q t a r e